

Në bazë të nenit 158-s pika 1) dhe në lidhje me nenin 150-a paragrafi(3) të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/2002, 84/2002, 98/2002, 33/04, 88/05, 79/07, 08/08, 88/08, 56/09, 67/10, 44/11 Këshilli i Ekspertëve të Agjensisë për mbikqyrje të sigurimeve miratoi

RREGULLORE

Për mënyrën dhe procedurën për pagesën dhe kalimin e primit të mbledhur nga ana e shoqërive për brokerim në sigurime

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

(1) Në këtë rregullore përshkruhet:

- Mënyra, procedura dhe proceset e mbledhjes të primit në bazë të kontratave të sigurimeve për të cilat shoqëria për brokerim në sigurime ka ndërmjetësuar midis klientëve dhe shoqërive të sigurimeve dhe risigurimeve (në tekstin si më poshtë: shoqëri sigurimi) dhe në llogari të saj por në emër të shoqërive të sigurimeve ka bërë mbledhjen e primit.
- Mënyra, procedura dhe afatet për kalimin e mjeteve monetare të mbledhura në bazë të primit për sigurime, shoqërive të sigurimit.

(2) Kjo rregullore nuk zbatohet nga shoqëritë për brokerim në sigurime të cilat në llogaritë e tyre nuk bëjnë mbledhjen e primit për sigurime, ose kur klienti direkt bën pagesën e primit për sigurime në llogari të shoqërisë të sigurimeve.

Neni 2

(1) Shoqëritë për brokerim në sigurime janë të obliguara të miratojnë akt të brendshëm me të cilin në mënyrë më të detajuar do të rregullojnë mënyrën, procedurën dhe proceset e mbledhjes të primit në bazë të kontratave të sigurimeve për të cilat kanë ndërmjetësuar, i cili më e pakta do të ketë të përfshira dispozitat e kësaj Rregulloreje.

(2) Shoqëritë për brokerim në sigurime janë të obliguara në kontratën për ndërmjetësim lidhur me shoqëritë e sigurimeve të përcaktojnë mënyrën e pagesës dhe afatet për kalimin e primit të mbledhur në bazë të kontratave të sigurimeve për të cilat kanë ndërmjetësuar, i cili më e pakta do të ketë të përfshira dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Mbledhja dhe kalimi i primit

Neni 3

(1) Shoqëritë për brokerim në sigurime të cilat kryejnë mbledhjen dhe pranimin e mjeteve monetare në bazë të primit për sigurime nga klientët –të siguruar /kontraktues, janë të obliguara pagesën ta kryejnë në llogari të vecantë bankare /të hapur/dhe destinuar/ vetëm për mbledhjen dhe pranimin e mjeteve monetare në bazë të primit për sigurim ndaj shoqërive të sigurimeve, për të cilat kanë ndërmjetësuar gjatë lidhjes të kontratave të sigurimeve.

(2) Shoqëria për brokerim në sigurime mund të hapë një ose më shumë llogari bankare sipas paragrafit 1 të këtij neni në banka komerciale të ndryshme.

(3) Në llogaritë parashikuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, mund të kryhet mbledhja, pranimi dhe pagesa e mjeteve në bazë të kontratave të sigurimeve të lidhura me shoqëritë e sigurimeve të ndryshme.

(4) Në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, shoqëria për brokerim në sigurime është e obliguar të sigurojë POS Terminalët nëpërmjet të cilave do të kryejë mbledhjen e primit nga të siguruarit/kontraktuesit, të jenë të lidhura direkt me llogarinë e veçantë bankare sipas paragrafit 1 të këtij neni.

(5) Në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, shoqëria për brokerim në sigurime është e obliguar të sigurojë mjetet në bazë të primit për sigurime të paguara kesh (me para në dorë) të kalojnë në llogari të vecantë bankare sipas paragrafit 1 të këtij neni jo më vonë se deri në fund të ditës të parë të ardhshme të punës nga dita kur këto janë paguar.

(6) Kalimin e mjeteve monetare në bazë të primit të paguar nga klientë/ të siguruar/kontraktues nga llogaritë sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni në llogari të shoqërisë për sigurime, shoqëria për brokerim në sigurime është e obliguar ta kryejë në afatin prej 15 ditësh nga dita e pagesës të mjeteve monetare nga të siguruarit/kontraktuesit, dhe paraprakisht sipas faturës së lëshuar nga ana e shoqërive të sigurimeve bashkë me specifikimin në të cilin do të jenë të shënuara të gjitha kontratat e sigurimeve për të cilat janë mbledhur mjetet monetare.

Dispozita përfundimtare

Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës të Maqedonisë”.

Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë

Kryetar

d.r Klime Popovski